112
12 3 20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr.______prot.

Tiranë, më ___.___.2020

Lënda: Dërgohet për mendim një projektvendim

KËSHILLIT KONSULTATIV
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE
**Adresa: Blv "Zhan D'Ark", Ish Shtëpia e Ushtarakëve, Kati VII**

**Tiranë**

Bashkëlidhur Ju dërgojmë për mendim projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr.1108, datë 30.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", të ndryshuar" dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

**Enea Hoti**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.2, Tiranë; Tel/Fax 35522667545; Web:www.Bujqesia.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ______datë____.____2020

PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1108, DATË 30.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 3, shkronja "dh", e 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në Tabelat 1 "Transferimi i Skemave Ujitëse", 1/1, "Tabela për transferimin e Infrastrukturës së Kullimit (sipas skemave kulluese)" dhe 2, "Tabela e Aseteve të qëndrueshme", bashkëlidhur vendimit nr.1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet përkatësisht sipas Anekseve 1, 1/1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Aneksi 1
Ndryshimet në Tabelën 1 "Transferimi i Skemave Ujitëse".

**Bashkia Poliçan:**
Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Poliçan | SKU - 27 | Plirez stacion pompimi | Stp. ( Osum ) | 1 | 1.7 | |

**Bashkia Skrapar:**
Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Skrapar | SKU - 27 | Plirez stacion pompimi | Stp. ( Osum ) | 1 | 1.7 | |

Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Skrapar | SKU-shtesa 1 | Nishov kanal | Burime (Nishov) | 1 | 0.7 | |
| Skrapar | SKU-shtesa 2 | Bargullas kanal | Burime (Bargullas) | 1 | 1.1 | |
| Skrapar | SKU-shtesa 4 | Straficke kanal | Burime (Straficke) | 1 | 1.1 | |
| Skrapar | SKU - 34 | Munushtir stacion pompimi 1 & 2 | Stp. ( Osum ) | 1 | 1 | |

**Bashkia Ura Vajgurore:**
Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ura Vajgurore | SKU - 34 | Munushtir stacion pompimi 1 & 2 | Stp. ( Osum ) | 1 | 1 | |

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ura Vajgurore | Ujitja me rezervuarin Malas Gropë | Malas Gropë | Rezervuari Malas Gropë | 1 | | |

**Bashkia Belsh:**
Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Belsh | ELU(B) -46 | Kanal ujitës Cartalloz | Lumi Devoll | | 2.7 | |
| Belsh | ELU(B) -29 | Kanal ujitës Dorbi | Liqeni i Dorbit | 1 | | |

**Bashkia Cërrik:**
Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Cërrik-Belsh | ELU(B) -46 | Kanal ujitës Cartalloz | Lumi Devoll | 1 | 9 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Cërrik | ELU(B) -46 | Kanal ujitës Cartalloz | Lumi Devoll | 1 | 2.5 | |

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Cërrik | ELU - 19 | KU.Rez.Tregan | Rezervuar (Tregan ) | | 5.6 | 19.9 |

Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Cerrik | ELU(B) -29 | Kanal ujites Dorbi | Liqeni i Dorbit | 1 | | |

**Bashkia Elbasan:**
Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Elbasan-Cërrik | ELU - 19 | KU.Rez.Tregan | Rezervuar (Tregan ) | 1 | 28 | 20 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Elbasan | ELU - 19 | KU.Rez.Tregan | Rezervuar (Tregan ) | 1 | 8.1 | 0.5 |

**Bashkia Librazhd:**
Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Librazhd | LB-ST-U | Rezervuari i Steblevës | Burime | 1 | 5 | |
| Librazhd | LB-OR-U | Rezervuari i Floqit | Burime | 1 | 1.5 | |
| Librazhd | LB-H-U-9 | Kanali i Fangut | Burime | 1 | 1.4 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Librazhd | LB-DO-U-6 Spa | Kanali i Gurkuqes | Burime | 1 | 0.8 | |
| Librazhd | LB-G-U-Gurakuq | Kanali Almate | Lume | 1 | 1.5 | |
| Librazhd | LB-OR-U-F | Kanali Lunik-Funarë-Zdrajsh | Burime | 1 | 9.6 | |
| Librazhd | LB-ST-U-Sebisht | Kanali i Sebishtës | Burime | 1 | 3 | |
| Librazhd | LB-PO-U-Vilan | KU-ST-Pompimi Vilan | Burime | 1 | 4 | |
| Librazhd | LB-DO-U-Dorez | KU-ST-Pompimi Dorez | K. Allanit | 1 | 4 | |
| Librazhd | LB-QE-U-Kuterman | KU-ST-Pompimi Kuterman | K. Kutermanit | 1 | 1 | |

**Bashkia Korçë:**

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Korçë | KOU - 78 | Lumalas st.pomp | Ventrok | 1 | 3 | |

**Bashkia Maliq:**

Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Maliq | KOU - 78 | Lumalas st.pomp | Ventrok | 1 | 3 | |

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Maliq | KOU-Zemblak | Diga Zemlak (+deget ujitese) | Diga Zemblak | 1 | 48 | 92 |

**Bashkia Pogradec:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pogradec | PGU - 30 | Katjel - Rodokal kanal | Rezervuar | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pogradec | PGU - 30 | Katjel - Rodokal kanal | Burimet Qafe Thane | 1 | | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pogradec | PGU - 38 | Pogradec st.pomp | | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pogradec | PGU - 38 | Verdovë st.pompimi | | 1 | | |

**Bashkia Has:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 1 | Fusha Golaj | Re.Lume Letaj, Golaj, Qarr, Dobrune | 1 | 54.8 | |

zëvendësohet me nëndarjet si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 1 | Golaj 1 | Rezervuar | 1 | 4.2 | |
| Has | HSU - 1 | Golaj 2 | Rezervuar | 1 | 2.4 | |
| Has | HSU - 1 | Golaj 3 | Rezervuar | 1 | 4.0 | |
| Has | HSU - 1 | Qarr 1 | Rezervuar | 1 | 1.6 | |
| Has | HSU - 1 | Qarr 2 | Rezervuar | 1 | 15.8 | |
| Has | HSU - 1 | Letaj | Rezervuar | 1 | 11.0 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 13 | Rosman | Lume | 1 | 1 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 13 | Rosman | Lumi Rosman | 1 | 2.5 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 14 | Krume | Lume | 1 | 1 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 14 | Kanali i rethit | Lumi Kruma | 1 | 2.6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 15 | Krume shore | Lume | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 15 | Kanali i Pekes | Lumi Kruma | 1 | 1.2 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 16 | Ferizoll | Lume | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 16 | Kanali Ferizoll | Lume | 1 | 3.6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 17 | Mazrrek | Lume | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 17 | Kanali Mazrrek | Lume | 1 | 1.6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 18 | Shtufe | Lume | 1 | | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU - 18 | Shtufi i Dides | Lumi Kruma | 1 | 2 | |

Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Has | HSU-19 | Vranisht nr.1 | Rezervuar | 1 | 3.1 | |
| Has | HSU-20 | Leshnice | Rezervuar | 1 | 11 | |

**Bashkia Mirditë:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 5 | Perlat | Rezervuar | 1 | 6 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 5 | Perlat Qendër | Rezervuar | 1 | 6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 4 | Prosek(Trojza) | Rezervuar | 1 | 12 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 4 | Trojez, Perlat | Rezervuar | 1 | 12 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 7 | Sheshi Kumonë | Rezervuar | 1 | 3.5 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirditë | MRU - 7 | Sheshi i Kumonës | Rezervuar | 1 | 3.5 | |

**Bashkia Malësi e Madhe:**

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër - Malësi e Madhe | MAU - 1 | Mbi Shkodra | Vau Dejë, stp | | | 96.3 |

**Bashkia Shkodër:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër-Vau Dejës | SHU - 4 | Nën Shkodër | HEC Vau Dejë | | | 71 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër-Vau Dejës | SHU - 4 | Nën Shkodër | HEC Vau Dejë | | 9.7 | 50.7 |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 2 | Juban - Gur Zi | Lumi Drin | 1 | 45 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 2 | Juban - Gur Zi | Lumi Drin + HEC Vau Dejë | 1 | 45.6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 3 | Ana e Malit | Stp Lum Buna | 1 | 25.6 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 3 | Ana e Malit | Stp. Lumi Buna | 1 | 26.6 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 6 | Ujitja Velipojë | Stp | 1 | 52 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkodër | SHU - 6 | Ujitja Velipojë | Stp. | 1 | 57.90 | |

**Bashkia Vau i Dejës:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vau Dejës | SHU - BVU | Bashkia Vau Dejë | Burimet e hidrocentralit | 1 | 7 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vau Dejës | SHU - BVU | Bashkia Vau Dejë | Burimet e hidrocentralit | 1 | 20.8 | |

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vau i Dejës | SHU-4 | Bashkia Vau Dejës | HEC Vau Dejë, Lumi Drin | | | 117.9 |

**Bashkia Kamëz:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-2 | Rez Cerkezë | Rez Cerkezë | 1 | 14.2 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-2 | Rezervuari Cerkezë | Rezervuari Cerkezë | | 14.2 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-3 | Rez Tapizë | Rez Tapizë | 1 | 11.5 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-3 | Rezervuari Tapizë | Rezervuari Tapizë (Tapizë 2) | | 11.5 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-7 | STP Cerkezë | STP Cerkezë | 1 | 5.5 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-7 | STP Cerkezë | STP Cerkezë | | 5.5 | |

Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kamëz | TRU - 1-8 | Stp Tapiza 2 | Stp Tapiza 2 | 1 | | |

**Bashkia Tiranë:**

Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Tiranë | TRU - 17-1 | Rezervuari Kashar | Rezervuari Kashar | 1 | | |
| Tiranë | TRU - 17-5 | Rezervuari Purrez | Rez ervuari Purrez | 1 | | |
| Tiranë | TRU - 1-2 | Rezervuari Cerkezë | Rezervuari Cerkezë | 1 | | |
| Tiranë | TRU - 1-3 | Rezervuari Tapizë | Rezervuari Tapizë (Tapizë 2) | 1 | | |
| Tiranë | TRU - 1-7 | STP Cerkezë | STP Cerkezë | 1 | | |
| Tiranë | TRU - 1-8 | Stp Tapiza 2 | Stp Tapiza 2 | 1 | | |

**Bashkia Vorë:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vorë | TRU - 17-1 | Rez. Kashar | Rez. Kashar | 1 | 17.4 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vorë | TRU - 17-1 | Rezervuari Kashar | Rezervuari Kashar | | 17.4 | |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vorë | TRU - 17-5 | Rez Purrez | Rez Purrez | 1 | 7.1 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vorë | TRU - 17-5 | Rezervuari Purrez | Rezervuari Purrez | | 7.1 | |

**Bashkia Patos:**

Shtohen nëndarjet si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Patos | FRU - 3-1 | Roskovec | Rezervuari Kurjanit | | | 20.214 |
| Patos | FRU - 30 | Belin elektro pomp | Lumi ( Seman ) | 1 | | |

**Bashkia Roskovec:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Roskovec | FRU - 3-1 | Roskovec | Rezervuar | 1 | 206 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Roskovec | FRU - 3-1 | Roskovec | Rezervuari Kurjanit | | | 121.55 |

**Bashkia Fier:**

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier | FRU - 1-1 | Fusha Hoxhares | Lumi Vjose | | | 278 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier | FRU - 1-1 | Fusha Hoxhares | Lumi Vjose | | 41.365 | 278 |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier-Lushnje | FRU - 4-1 | Myzeqe | Rez. Thane | 1 | 46 | |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier | FRU - 4-1 | Myzeqe | Rez. Thane | | | 35.5 |

Hiqet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier | FRU - 30 | Belin elec. pomp | Lume ( Seman ) | 1 | | |

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fier | FRU - 3-1 | Roskovec | Rezervuari Kurjanit | | | 14,18 |

Aneksi 1/1

Ndryshimet në Tabelën 1/1 "Tabela për transferimin e Infrastrukturës së Kullimit (sipas skemave kulluese)".

Bordi i Kullimit "**Shkodër**":

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | Vau Dejës | Gline-Gjadër-Drin i Lezhës SHK-4 | 2,250 | | 1 | 1 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | Vau Dejës | Gline-Gjadër-Drin i Lezhës SHK-4 | 3,250 | | 1 | 1 |

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | Shkodër-Vau Dejës | Mertemze-Vilu-Det SHK 6 | 9,160 | | 1 | 1 |

zëvendësohet me nëndarjet si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | Vau i Dejës | Mërtemzë-Vilu-Det SHK 6 | 4,760 | | 1 | 1 |
| 29/1 | Shkodër | Mërtemzë-Vilu-Det SHK 6 | 4,400 | | 1 | 1 |

Bordi i Kullimit "**Elbasan**":

Shtohet nëndarja si vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 94/1 | Elbasan | Kolektori Kullues (përroi Postokav) | 300 | 1 | 1 | |

Bordi i Kullimit "**Fier**":

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Fier | Kullimi i Fushes se Hoxhares FRK 1,2,3,4 | 22.980 | | 1 | 1 |

zëvendësohet me nëndarjet si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Fier | Kullimi i Fushes se Hoxhares FRK 1,2,3,4 | 20.830 | | 1 | 1 |
| 11/1 | Patos | FRK 4 | 2.150 | | 1 | 1 |

Bordi i Kullimit "**Vlorë**":

Nëndarja:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 64 | Finiq | Total SRK-10 Fusha e Navarices | 244 | 1 | 1 | 1 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 64 | Finiq | Total SRK-10 Fusha e Navarices | 340 | 1 | 1 | 1 |

Aneksi 2

Ndryshimet në Tabelën 2 "Tabela e Aseteve të Qëndrueshme".

**Bordi i Kullimit Elbasan:**

Nëndarja:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkia Elbasan | 1-Zyra | 7418 | 140 |
| | 2-Ambiente të tjera N/1 | | 295 |

zëvendësohet me nëndarjen si më poshtë vijon:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkia Elbasan | 1-Ish zyrat e Bordit të Kullimit Lagjia Çlirimi | 340 | 795 |
| | 2-Zyra dhe Ambiente të tjera, Lagjia "Shkumbini" | 7235 | 2294.9 |

# RELACION

# PËR

# DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1108, DATË 30.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT", TË NDRYSHUAR

## I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim disa ndryshime në VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", për saktësimin e vendodhjes së një pjese të infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, të transferuar te bashkitë, sipas ndarjes territoriale midis bashkive.

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar Regjistrin e Projektprogramit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2020 dhe është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural dhe në veçanti për përmirësimin e menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar te bashkitë .

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në zbatimin e VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", pjesa më e madhe e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (rrjetet e kanaleve ujitëse dhe kulluese si dhe digat e rezervuareve), i është transferuar bashkive, me parimin, që skemat ujitëse e kulluese, që shtrihen në territorin e një bashkie, ti përkasi asaj bashkie.

Gjatë procesit të zbatimit të VKM nr.1108, datë 30.12.2015 dhe menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, disa bashki kanë propozuar, që të bëhen disa ndryshime/saktësime të përkatësisë së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, midis bashkive, referuar kufirit të ndarjes territoriale.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2019, janë bërë disa komunikime zyrtare me të gjitha bashkitë, që të shpreheshin në lidhje me inventarin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të transferuar atyre.
Nga shqyrtimi i propozimeve rezulton, se është e nevojshme të bëhen disa ndryshime/saktësime, që kanë të bëjnë kryesisht me vendodhjen e kanaleve ujitëse, kulluese (pjesë të tyre), burimeve ujore (stacione pompimi, diga të rezervuareve etj) dhe aseteve të paluajtshme, për 23 bashki.

Gjithashtu nisur nga mosmarrveshjet midis bashkisë Roskoves dhe Patos në furnizimin me ujë nga kanali kryesor ujitës i rezervuarit të Kurjanit, që aktualisht administrohet nga bashkia Roskovec, me ndryshimet e propozuara në këtë projektvendim, ky kanal rikthehet në administrimin e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier. Në këtë mënyrë synohet një shpërndarje më e drejtë e ujit ndërmjet bashkisë Roskovec dhe Patos.

Ky projektvendim, siç është vepruar edhe me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, propozohet me bashkëfirmosje me Ministrinë e Brendshme, si dhe do të bashkërendohet duke i'u dërguar për mendim Agjencisë për Mbeshtetjen e Veteqeverisjes Vendore dhe ministrive të linjës.
Miratimi i këtyre ndryshimeve do të ndikojë në menaxhimin më të mirë të ujitjes dhe kullimit si dhe në monitorimin e sigurisë së digave nga bashkitë.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.115/2014,"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 3,shkronja "dh", e 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE-së* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk përafron Acquis e BE-së.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi, në pikën e parë, përcakton ndryshimet në Tabelat 1, 1/1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave. Këto ndryshime pasqyrohen në ankekset bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Në pikën e dytë, përcaktohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij vendimi nuk ka efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit.

MINISTRI BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Bledar Çuçi

MINISTRI BRENDSHËM

Sandër Lleshaj